

**“VDEKJE DHE DËBIM” I JUSTIN MCCARTHY  
- NJË KËNDVËSHTRIM I RI I HISTORISË  
PËR TA KUPTUAR ATË**

Objekti i librit “Vdekje dhe dëbim”, botuar nga shtypshkronja “Maluka”, në Tiranë, 2015, ka të bëjë me historinë dhe fatin e miliona myslimanëve të perandorisë osmane në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Zonat e Ballkanit, të Lindjes së Mesme dhe të ish-Bashkimit Sovjetik, kanë qenë qendra konflikti etnik dhe fetar, që ka patur si pasojë dëbimin dhe vdekjen e miliona myslimanëve.

Autori i librit “Vdekje dhe dëbim” i Prof. J.McCarthy ka shkruar gjerësisht për historinë e popujve të Ballkanit dhe të Lindjes së Mesme. Ai është autor edhe i mjaft librave të tjerë, si: “Bota arabe, Turqia dhe Ballkani (1878-1914)”, “Myslimanët dhe pakicat. Popullsia e Anadollit osman dhe fundi i perandorisë”, “Popullsia e Palestinës: Historia e popullsisë dhe statistikat e periudhës së vonë osmane dhe të Mandatit” (1990).

Trajtimin e kësaj teme autori e bën me një metodologji ndryshe nga sa është shkruar historia e perandorisë osmane. Sipas Prof. McCarthy-it historia e ekspansionit të perandorisë ruse dhe e krijimit të vendeve të reja në Ballkan, tradicionalisht është trajtuar nga këndvështrimi i kombeve të krishtera që dolën nga perandoria osmane. Ndryshe nga ky këndvështrim, libri “Vdekje dhe dëbim” e trajton historinë nga pozita e turqve dhe e myslimanëve të tjerë, të cilët pësuan vdekje dhe dëbim si pasojë e imperializmit, nacionalizmit dhe konfliktit etnik.

Nisur nga ky këndvështrim rreth historisë së popujve të Lindjes së Mesme dhe të Ballkanit, libri i J. McCarthy-it paraqet një kornizë të re për t’i kuptuar mosmarrëveshjet që vijojnë edhe në ditët tona.

Autori e ndërton librin mbi fakte konkrete, dhe sidomos mbi faktin historik se myslimanët e Europës Juglindore ishin masakruar nga të tjerët (jomyslimanë). Ndonëse shifrat dhe statistikat që sjell

autori nuk ofrojnë një saktësi absolute të shqiptarëve myslimanë që iu nënshtruan këtyre vdekjeve dhe dëbimeve, megjithatë ky numër ia vlen të merret në konsideratë.

Sipas autorit, shifrat që kanë paraqitur autorët nacionalistë, të cilët kanë pretenduar në librat e tyre për dallimin e serbëve, bullgarëve apo maqedonasve, janë të sajura.

Libri "Vdekje dhe dëbim" zbulon rrethanat historike me të cilat fillon vrasja dhe migrimi i myslimanëve në Europën Osmane dhe më konkretisht i shqiptarëve në kuadrin e kësaj popullsie. Luftrat shkaktuan migrimin e shqiptarëve në Greqinë Jugore dhe në Serbi që në fillim të shek. XIX. Ndërsa Luftrat Ballkanike 1912-1913, vë në dukje autori, u sollën shqiptarëve një prej katastrofave më të rënda, të dëshmuara ndonjëherë nga popujt në Europë.

Edhe pse në Shqipërinë e pllakosur nga lufta ishte e pamundur që të bëhej një census (regjistrim) i popullsisë së mbijetuar, konsujt britanikë dhe të vendeve të tjera shpesh kanë raportuar me saktësi atë që iu është bërë shqiptarëve. Midis të tjerave, konsujt tregojnë se Mali i Zi pasi mori trojet shqiptare të Veriut në vitin 1878, vrau ose dëboi me dhunë të gjithë shqiptarët e territoreve të pushtuara.

Të dhënat e Luftrave Ballkanike tregojnë se në Ballkanin Qendror dhe në atë Perëndimor 27 përqind e myslimanëve kanë vdekur dhe 35 përqind e tyre kanë marrë arratinë. Shqiptarët pësuan një vdekshmëri që ishte të paktën po aq e madhe.

Libri "Vdekje dhe dëbim" jep jo vetëm katalogun e vuajtjeve të myslimanëve, por edhe të të krishterëve. Kjo do të thotë se pushtuesit nga Mali i Zi dhe Serbia rrënuan si fshatrat e shqiptarëve myslimanë dhe ato të krishterëve pa dallim. Greqia, nga ana e saj, vëren autori, zaptoi trojet e shqiptarëve pa marrë parasysh fenë e banorëve të tyre. Duke marrë parasysh një fakt të tillë, nuk mund të thuhet se kush vuajti më tepër. Shqiptarët u bënë viktima të katastrofës së kombit të tyre.

Prof. J. McCarthy-i hedh poshtë si të pavërtetë, pikëpamjen e evropianëve të cilët e cilësuan nënshtrimin e myslimanëve të Europës Osmane si një të drejtë të shumicave të krishtera për vetëqeverisje. Ai sjell si argument kundërshtues pohimin se në vitin 1912 myslimanët ishin grupi më i madh në Evropën Osmane. Në tërësi myslimanët ishin shumicë (shqiptarët në perëndim të perandorisë osmane dhe turqit në lindje). Prandaj, ajo që ndodhi në të vërtetë ishte mohimi i të drejtave të shumicës.

Autori i librit “Vdekje dhe dëbim” shpreh shqetësimin se librat e historisë edhe sot e kësaj dite ende e shpërfillin fatkeqësinë që i pllakosi myslimanët. Duke i vendosur humbjet e jetëve të shqiptarëve në tablonë e gjerë të spastrimit etnik të të gjithë myslimanëve osmanë, autori shpreson se me këtë libër, do t’u përçohen rrëfime evropianeve dhe të tjerëve që të njohin më mirë historinë e shqiptarëve.

Duke iu referuar dokumenteve të shumta arkivore si dhe mjaft dëshmime njerëzore, Prof. McCarthy arrin në përfundimin se ndërmjet viteve 1821 dhe 1922, më tepër se 5 milionë myslimanë ishin dëbuar nga trojet e tyre dhe 5, 5 milionë të tjerë vdiqën nga lufta ose u shuajtën si refugjatë nga uria dhe sëmundjet. Këtë e tregon harta bashkëkohore e Ballkanit dhe e Kaukazit Jugor, e cila paraqet vende me popullsi homogjene që u krijuan në vazhden e lufrave që i ndanë ato nga perandoria osmane. Uniteti i tyre etnik dhe fetar, – konstaton autori, – u arrit nëpërmjet dëbimit të popullsisë myslimane.

Këndvështrimi “tradicional” i historisë së vendeve të Ballkanit, të Kaukazit dhe të Anadollit, pa përmendur askund historinë e një prej protagonistëve kryesorë, atë të myslimanëve, e bën këtë histori më pak se sa të plotë, në mos çorientuese për shkak se historitë e grupeve pakicë osmane janë nxjerrë nga konteksti. Ndaj Prof. McCarthy mbështet idenë se puna e historianit është rishqyrtimi i historisë së njëanshme dhe ndryshimi i urtësisë tradicionale të mangët.

Autori i këtij libri ka identifikuar faktorët që ndikuan në fatin e hidhur të myslimanëve të perandorisë osmane. Ndër këta faktorë ai rendit dobësinë ushtarake dhe ekonomike të perandorisë osmane, e cila nuk ishte në gjendje të mbronte myslimanët e saj.

Lindja e nacionalizmit në gjirin e popujve të krishterë si dhe ekspansioni perandorak rus përbënin faktorët e tjerë për vdekjen dhe dëbimin e myslimanëve të perandorisë osmane.

Elementi fetar në nacionalizmin e pakicave ushquu kthjelltësinë e qëllimit të nacionalistëve për të identifikuar më lehtë armikun. Myslimanët, si të tillë, konsideroheshin si armiq kombëtarë nga secili grup nacionalist (grek, serb, malazez, bullgar etj.). Myslimanët nuk duhet të toleroheshin si pjesë e kombit të tyre, pasi ata nuk ishin si vëllezër etnikë, ata ishin “të pafe”. Ky

ishite një nga shkaqet e dëbimit me dhunë të myslimanëve që shoqëroi çdonjërin prej revolucioneve dhe lëvizjeve kombëtare, përfundon autori. Thirrja patriotike e revolucionit grek, e shpallur nga argjipeshkvi Germanos ishte: “Paqe të krishterëve! Respekt konsujve! Vdekje turqve”!

Të dhënat dhe faktet që sillen me shumicë në libër janë rrënjëqethëse e tronditëse. Turqit ose myslimanët konsideroheshin pa asnjë dyshim një kolonë e pestë përkundruall Revolucionit Grek. Mbi 25 mijë myslimanë janë vrarë nga revolucionarët grekë (f. 32 e librit). Politika e spastrimit të krahinave nga popullsitë e tyre myslimane në emër të “pavarësisë kombëtare” u shfaq edhe në luftrat e viteve 1877-1878, 1912-1913, 1919-1923. Në të gjitha këto luftra qëllimi ishte i njëjtë me atë të revolucionarëve grekë të vitit 1821, krijimi i kombeve të bashkuara, duke shkatërruar grupin fetar dhe etnik që përbënte pengesë.

Krijimi i një kombi duke përjashtuar turqit dhe myslimanët e tjerë është një parim që u ndoq pas grekëve edhe nga bullgarët, rusët dhe armenët. Në luftrat e shek. XIX dhe të fillimit të shek. XX të marra në shqyrtim nga autori i këtij libri, arrihet në përfundimin se myslimanët u masakruan dhe u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre.

Është e pamundur, - tërheq vëmendjen Prof. McCarthy, - një kuptim i historisë së përgjithshme të perandorisë osmane dhe ruse si dhe i historisë së popujve jomyslimanë të të dyja perandorive, pa kuptuar më parë fatin e myslimanëve. Pikërisht me këtë kontribut, ky libër ndihmon në kuptimin më të plotë të historisë, gjë që e bën të domosdoshëm në duart e lexuesve dhe studiuesve.